

ÇDO VOTUES, ËSHTË VËZHGUES.



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitesa
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

pzap.rks-gov.net

ÇFARË ËSHTË ANKESA?

Ankesa është një shkelje e supozuar e ligjeve apo rregullave zgjedhore, e dorëzuar me shkrim nga një person që ka interes ligjor apo të drejtat e të cilit janë dëmtuar gjatë procesit zgjedhor.

KUSH KA TË DREJTË TË ANKOHET?

Të gjithë me të drejtë vote, përfaqësuesit e subjekteve politike, komisionerët e vendotimeve dhe vëzhguesit vendas kanë të drejtë të ankohen.

SI DUHET TË DORËZOHET ANKESA?

Që një ankesë të konsiderohet për hetime të mëtutjeshme, duhet të:

- Dorëzohet nga një person i cili ka të drejtë të ankohet (përmendur më lartë);
- Dorëzohet brenda afatit kohorë (shiko më poshtë).
- Dorëzohet me shkrim duke plotësuar formularin e PZAP-it (Aneksi A), që mund të merret në Sekretariatën e PZAP-së, në ueb-faqen e PZAP-së dhe gjithashtu në të gjitha qendrat e votimit në ditën e zgjedhjeve. Ankesa mund të shkruhet edhe në letër të thjeshtë përderisa l përfshin të gjitha elementet kryesore të një ankese.
- Referoj dispozitat që janë shkelur në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale, rregullat e KQZ-së apo PZAP-së;
- Të jetë e nënshkruar nga personi që ka dorëzuar ankesën

ÇFARË DUHET TË PËRMBAJË NJË ANKESË?

Ankesa që dorëzohet në PZAP duhet të përmbajë:

- Emrin, adresën dhe kontaktet e personit i cili është ankuar;
- Përshkrimin e detajuar të shkeljes së supozuar, përfshirë edhe datën, kohën dhe vendin e ngjarjes;
- Detajet lidhur me ndonjë dëshmi, ndonjë kopje të ndonjë dokumenti relevant, fotografi, video-audio inqizim, apo lloje të tjera të dëshmive që mbështesin ankesën, apo ndonjë udhëzim se ku mund të gjendet dëshmia, nëse nuk është në posedim të ankuesit
- Vërtetimin nga ankuesi për vërtetësinë e përmbajtjes së ankësës.

Aty ku është e mundur, ankesa duhet gjithashtu të sigurojë:

- Emrin, adresën dhe kontaktet (nëse ato ekzistojnë) e personit që ka kryer shkeljen e supozuar;
- Emrin, adresën dhe kontaktet (nëse ato ekzistojnë) të ndonjë dëshmitari.

KU MUND TA DORËZONI ANKESËN?

Ankesa duhet të dorëzohet në kutinë postare të PZAP-së, ose në zyret e PZAP-së në **rr. Luan Haradinaj Prishtinë, Kosovë 10000**.

KUR DUHET TË DORËZOHET ANKESA?

Afate të ndryshme kohore aplikohen për faza të ndryshme të procesit zgjedhor:

- Ankesat që nuk kanë të bëjnë me procesin e votimit dhe numërimit të votave, sikurse, ankesat në lidhje me fushatat politike dhe financave, shkeljet e kodit të mirësjelljes, të mediave dhe të tjera duhet **të dorëzohen brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga momenti kur shkelja e supozuar ka ndodhur**.
- Ankesat që kanë të bëjnë me procedurat e votimit apo numërimit gjatë ditës së zgjedhjeve, duhet **të dorëzohen në PZAP brenda njëzet e katër (24) orëve pas mbylljes së votimit**.
- Ankesat lidhur me procedurat në Qendër të Numërimit dhe Rezultateve (QNR), duhen **të dorëzohen brenda njëzet e katër (24) orëve nga moment kur shkelja e supozuar ka ndodhur**.

Shënim i rëndësishëm: Vetëm arritja e ankësës në kohën e duhur është e obliguar. Ankuesit mund t'i jepet më shumë kohë nga PZAP-i për të siguruar dëshmi për shkeljen e supozuar.

PZAP.RKS-GOV.NET

Formulari mund të merret në Sekretariatën e PZAP-së, në ueb-faqen e PZAP-së dhe gjithashtu në të gjitha qendrat e votimit në ditën e zgjedhjeve.